

VENDIM
Nr.11, datë 25.1.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE
NR.100, DATË 27.12.2006 “RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHKËMBIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa 1 dhe nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 12 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.100, datë 27.12.2006 “Rregullat dhe procedurat e shkëmbimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 25.1.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “KESH” sh.a. për ndryshime dhe shtesa në “Rregullat e procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike”,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në rregullat e procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike si më poshtë:

- Në nenin 3 pika 3, shtohet në fund të fjalisë së parë përmbajtja: si dhe në rastet e avarive në sistemin e transmetimit.

- Në nenin 3, pika 7, pas fjalës Fax shtohet fjala E-mail.

- Në nenin 4, në paragrafin ku shprehet “në programin vjetor” shtohet fjala të miratuar

- Në nenin 7 (Kërkesa) ndryshon si vijon:

- Fuqinë në MW

- Sasinë e energjisë elektrike MWH

- Grafikon ditor të lëvrimit

- Kohëzgjatjen e lëvrimit në ditë/javë

- Periudhat e shkëmbimit (marrje-dhënie)

Në nenin 8, pika 1, paragrafi i parë ndryshon si vijon:

Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a. i propozon Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë parashikimin për nevojën vjetore për shkëmbimet për situatat e parashikuara.

Në nenin 11, paragrafi i parë ndryshon si vijon:

KESH sh.a. modifikon grafikun “Muaj/javë/ditë në avancë”, sipas rregullave të tregut dhe ia paraqet OST sh.a në përputhje me energjinë elektrike që do të shkëmbehet.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta